

**“PANAIRI I IDEVE”, SHPALL FITUESIT**

Pas “Panairit të Ideve” të zhvilluar në kuadër të projektit ECSRA, u mundësua përzgjedhja dhe mbështetja financiare në formën e grant-eve të vogla të nismave të njëzetë OJF-ve për qarkun e Lezhës, Beratit, Gjirokastrës dhe Elbasanit për t’u zbatuar gjatë periudhës Gusht-Nëntor 2012. Nismat adresojnë një sërë problematikash të komunitetit në zonat rurale dhe periferike. Disa prej nismave përqendrohen në fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit, barazinë gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në qeverisjen vendore si dhe ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve rurale. Gjithashtu nuk mungojnë nismat të cilat kanë në fokus nevojat e grupeve vulnerabël si: komuniteti rom, të rinjtë në zonat rurale dhe inkurajimi i harmonisë ndërmjet grupeve minoritare. Krahas kësaj, iniciativat të tjera synojnë nxitjen e krijimit të rrjeteve të fermerëve për zhvillimin e biznesit rural dhe ndikimi i politikave për zhvillimin bujqësor në qarqet respektive.

KUÇOVË - SHOQATA “NDIHMË SOCIALE GRUAS KRYEFAMILJARE”**Përfundon Cikli i Nismave në kuadër të “ECSRA-s”**

Shoqata “Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare” me qendër në Kuçovë, zhvilloi aktivitetet e saj në kuadër të projektit ECSRA. Një sërë takimesh u zhvilluan me të rinj e të reja të moshave të ndryshme mbi 16 vjeç, për t’i njohur qytetarët me iniciativat e këtij projekti, përfitimet dhe objektivat final. Gjatë takimeve njohëse u përzgjedhën rreth 30 të rinj, të cilët u caktuan edhe si “mbështetësit” për vazhdimësinë e projektit. Në këtë fazë u veçuan



ata të rinj me aftësi lidhësi në grupet e tyre shoqërore. Në këtë kontekst nisma e shoqatës Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare, me qendër në Kuçovë përfshinte aktivitetet promovuese, vlerësim të situatës, si dhe ngritje kapaciteteve për komunitetin lokal në Kuçovë mbi barazinë gjinore. Pas mbledhjes së materialeve, organizimit të trajnimeve dhe materialeve promovuese nisën aktivitetet në terren për sensibilizimin e të rinjve mbi çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Disa qindra fletëpalosje me informacion ndërgjegjëses u shpërndanë tek banorët ku promovohet nxitja e barazisë gjinore. Një pyetësor që trajtojnë çështjet kyçe të barazisë gjinore në qytetin e Kuçovës iu shpërnda komunitetit me synim analizimin dhe vlerësimin e situatës në terren. Aktivitetet promovuese vazhduan me rreth 30 të rinj e të reja të veçuar me bluzat e kapele të stampuara me

sloganin e projektit të cilët shpërndanë materiale ndërgjegjëse në kuadër të kësaj nisme. Në muajin shtator, shoqata “Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare” realizoi edhe trajnimin me 30 të rinj e të reja nga Kuçova për edukim gjinor, dhe çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. I pranishëm në këtë trajnim ishte edhe një përfaqësues i grupit “Barazia Gjinore” nga Korpusi i Pages.

**OJQ-TË FITUESE NË PANAIRIN E IDEVE**

Qendra e Informacionit Aarhus – Vlorë, Qendra Kulturore Mediatike Antigonea (QKMA), Seksioni Ndërkombëtar Shqiptar (CIOFF), Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO), Qendra për Menaxhimin Agro-Mjedisor dhe Ekonomik (AEEM), Shoqata Gruaja Vizioni i Ndryshimit Lezhë, Shpresë për të varfrit, Komiteti Rinor Lezhë, “Romët e Veriut”, Shoqata “Gruaja Ndryshe” Librazhd, Projekti Ndërkombëtar i Mëshqerrave (PNM), Shoqata “Në dobi të gruas shqiptare”, Qendra “Shërbimet Bujqësore Elbasan” Sh.B.E, Shoqata e burimeve natyrore të komunës Gjinor, Shoqata “Tjetër Vizion”, Forumi Gruas Elbasan, Shoqata “Jetimet në Fokus”, Berat, Mbrojtja e të drejtave të Grave Qytetare dhe Fshatare, Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare dhe Qendra Mjedimore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim – EPER Center.

**LIBRAZH****“Vlerat e Trashëgimisë Kulturore” në një Panair**

Shoqata “Gruaja Ndryshe” përfundon aktivitetet në kuadër të ECSRA-s

Në kuadër të projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike” që IDM dhe PNUD po implementojnë në bashkëpunim me organizatat lokale, shoqata “Gruaja Ndryshe - Librazhd” përfundoi aktivitetet e saj në kuadër të nismave për të nxitur vlerat e trashëgimisë kulturore në zonën e Librazhdit nëpërmjet organizimit të



Panairit të Vlerave dhe Trashëgimisë Kulturore. Aktivitete përgatitore u zhvilluan gjatë muajve korrik dhe gusht ndërkoë takime njohëse u zhvilluan në qytetin e Librazhdit me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave të zonës. Pjesëmarrësit u njohën me projektin dhe u diskutua në grup për mënyrën e zbatimit të tij. Takime të tjera u zhvilluan në grupe të vogla në fshatra ku gratë banojnë, për të parë nga afër si ato organizohen dhe bashkëpunojnë me njëra tjetrën. “Panairi i Vlerave dhe Trashëgimisë Kulturore” u realizua në 22 Shtator 2012, në Librazhd, me pjesëmarrje të gjerë të grave dhe vajzave të zonës, të cilat prezantuan punimet e dorës dhe gatimet e zonës për të ftuarit. Një punë të mirë kishin bërë edhe gratë e komunitetit



egjiptian me prezantimin e punëve të tyre të dorës. Qëllimi i aktivitetëve është jo vetëm përçimi i vlerave kulturore tek komunitetet, por edhe sensibilizimin e grave në zonat rurale mbi rolin e tyre më aktiv në jetën social-kulturore dhe zhvilluar kapacitetet e tyre në zhvillimin e zonës.

ELBASAN**“FORUMI I GRUAS” në aktivitete me komunitetin ...**

Projekti rajonal ECSRA u shtri në rrethin e Elbasanit, ku organizata “Forum i Gruas” përfundoi ciklin e aktivitetëve në kuadër të projektit “Nxitja e Pjesëmarrjes së Komunitetit në Mirëqeverisjen Vendore



nëpërmjet Ndërgjegjësimi të tyre”. Fokus grupi me temë: “Shërbimet sociale, kushtet shëndetësore dhe arsimit” që u zhvillua në komunën Shushicë të rrethit të Elbasanit kishte si objektivi informimin e komunitetit rreth situatës së shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore, rritjes së transparencës nga ana e ofruesve të shërbimeve si dhe marrjen e angazhimeve të përgjegjshme të këtyre ofruesve të shërbimeve për t’i dhënë zgjidhje problemeve. Takimi synonte të nxishte qytetarinë aktive dhe përmirësimin e qeverisjes në nivel vendor duke ndërgjegjësuar të pranishmit mbi



ndihmën ekonomike, transportin, trajtimin shëndetësor, shkollimin etj. Sipas organizatorëve, takimi kaloi në një frymë mjaft të hapur bashkëpunimi dhe pritjet që ballafaqimi i komunitetit me përfaqësuesit e institucioneve lokale, të ndikojë ndjeshëm në zgjidhjen e problemeve të tyre.

GJIROKASTËR**“Panairi VI Kombëtar i Trashëgimisë dhe Artizanatit 2012”**

Në Gjirokastrë nga data 28 - 30 shtator, u zhvillua “Panairi VI Kombëtar i Trashëgimisë dhe Artizanatit”. Ky aktivitet, i cili organizohet nga Fondacioni “Gjirokastra” në bashkëpunim me institucione të tjera, këtë vit u mbështet nga IDM dhe PNUD



në kuadër të Projektit “Fuqizimi i shoqërisë civile në zonat rurale”. Për 3 ditë rrugët e kalldrëmta, me këtë rast të liruara nga trafiku i makinave, u mbushën me qytetarë dhe vizitorë që u njohën me punime të 120 artizanëve nga e gjithë Shqipëria dhe Kosova. Panairi është aktiviteti më i madh në Shqipëri për artizanatin shqiptar që zhvillohet rregullisht dhe, është kthyer në një ngjarje të rëndësishme për qytetin. Edhe në këtë edicion u zhvillua si zakonisht një tryezë e rumbullakët për probleme të artizanatit, trashëgimisë dhe turizmit. Tema e këtij viti ishte “Përpjekjet e bashkërenduara për zhvillimin e produktit



turistik në rajonin e Gjirokastrës, krijimi i një Forumi aktiv për organizimin e Panairëve në të ardhmen”. Ky projekt ka për qëllim të mundësojë partneritet midis sektorit privat, publik dhe atij civil për përmirësimin e ofertës turistike në Rajonin e Gjirokastrës nëpërmjet krijimit të Forumit për Zhvillimin e Turizmit në Gjirokastrë.

Instrumenti për Asistencën e Para-aderimit (IPA) Greqi – Shqipëri
Instrumenti për Asistencën e Para-aderimit (IPA) Mali i Zi – Shqipëri

Thirrje (II) për Projekt Propozime

Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është të nxisë bashkëpunimin ndërmjet njerëzve, komuniteteve dhe institucioneve në zonat kufitare, duke synuar marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe të qëndrueshme të zhvillimit. Programi synon të ndërtojë kapacitetet e palëve në nivelet lokale, komunale, rajonale.

Objektivat specifike të programit përfshijnë:

- Promovimi i zhvillimit ekonomik të zonës
- Mbrojtja, promovimi dhe menaxhimi i ekosistemeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit
- Bashkëpunimi dhe ndërtimi i partneritetëve përtej kufinjve

• Forcimi i kapaciteteve kombëtare dhe të përbashkëta, për menaxhimin e programit ndërkufitar

• Zhvillimi ekonomik me theks në turizëm

Komponentet e IPA-s:

- I. Asistenca për Tranzicionin dhe Krijimi i Kapaciteteve Institucionale;
- II. Bashkëpunimi Ndërkufitar;
- III. Zhvillimi Rajonal;
- IV. Zhvillimi i Burimeve Njerëzore;
- V. Zhvillimi Rural.

MBËSHTETJE PËR ORGANIZATAT MJEDISORE TË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

Qendra Rajonale e Mjedisit me mbështetjen e Ambasadës Suedeze dhe Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA) lancojnë programin “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri” (SENIOR-A). Programi synon të kontribuojë në forcimin e organizatave joqeveritare duke përmirësuar aspektet organizative si proceset vendimarrëse, transparencën publike, etj. OShC me projekte të orientuara në programe me planifikim strategjik, efektshmëri në zbatim dhe ndikime afatgjatë në komunitetet janë të mirëpritura të aplikojnë.



“ECSRA”

Monitorimi i Nismave të Mbështetura



Në kuadër të ECSRAS ka filluar implemtimi i fazës së monitorimit të iniciativave të mbështetura nga ky projekt. Si rrjedhojë është hartuar një fletë-vlerësimi për aktivitetet që do të monitorohen si dhe është planifikuar axhenda për monitorim në të katër qarqet e targetuara nga projekti (Berat, Lezhe, Elbasan, Gjirokastrë). Procesi i monitorimit do të përfshijë monitorime të drejtpërdrejta, me vizita në aktivitetet e planifikuara në kuadër të nismave të ndërmarra, monitorim përmes dokumentacioneve relevante si

dhe përmes kontakteve elektronike, si dhe aplikimit të fletëve të monitorim-vlerësimit që do të plotësohen nga organizatat implementuese. Monitorimi do të ketë një shtrirje kohore që garanton përputhshmëri me kalendarin e aktiviteteve të propozuara nga secila iniciativë që ka marrë mbështetje nga ECSRA dhe do të implementohen në të ardhmen. Nismat në kuadër të këtij projekti do të përfundojnë në fund të muajit nëntor duke arritur drejt finalizimit të kësaj nisme.

“NISMA TE TJERA”

Ngritja e Rrjetit të Organizatave të Grave me Aktivitet në Zona Rurale

Në kuadër të projektit “Axhenda Gjinore për Zhvillimin Rural – Forcimi i Grave në Shoqërinë Rurale” (GARD) i financuar BE, IDM ka iniciuar procesin e krijimit të rrjetit të organizatave të grave me aktivitet në zonat rurale. Puna për ngritjen e këtij rrjeti ka nisur me një proces konsultues me aktorë kyç në fushën e zhvillimit rural dhe përkatësisë gjinore në vend si përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, përfaqësues të organizatave dhe donatorëve që kanë në prioritetet e tyre zhvillimin rural dhe përkatësinë gjinore / të drejtat e grave, përfaqësues të pushtetit vendor në zona rurale. Ky proces ndihmoi në ravijëzimin e strategjisë që do të ndiqej si dhe në identifikimin dhe bashkërendimin e burimeve dhe përpjekjeve të deritanishme në këtë drejtim. Deri tani ka përfunduar identifikimi i organizatave të profilit të kërkuar nëpërmjet



jet databazave egzistuese. Kjo do të pasohet me hulumtime të drejtpërdrejta në terren, veçanërisht në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe organizatat me qendër në këto zona, për identifikimin e organizatave apo iniciativave të tjera që mund të ekzistojnë, por që ende nuk kanë gjetur pasqyrimin në databazat e deritanishme.



Organizatave Lokale në një “Panair të Ideve”

IDM në bashkëpunim me PNUD organizoi në Tiranë “Panairin e Ideve” me pjesëmarrjen e organizatave lokale nga Elbasani, Gjirokastra, Berati dhe Lezha.

IDM dhe PNUD në përfundim të fazës së parë të projektit “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale në Shqipëri” (ECSRA), në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile nga zonat rurale dhe periferike të Qarqeve Lezhë, Elbasan, Berat dhe Gjirokastrë organizuan në kryeqytet në ambjentet e Hotel Tirana, “Panairin e Ideve”.

Në këtë eveniment përfaqësues nga 40 organizata joqeveritare, prezantuan idetë dhe iniciativat e tyre mbi projekte lokale në zonat periferike dhe rurale. Ky aktivitet tërhoqi vëmendjen e mjaft donatorëve, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare dhe shoqëria civile. Kjo nismë synon të forcojë kapacitetet e organizatave joqeveritare në zonat rurale dhe periferike.



ike duke i dhënë më shumë zë komuniteteve lokale në këto rajone. Në takim, foli Drejtoresha e PNUD-it Znj. Yesim Oruc, e cila u përqëndrua në rëndësinë e zhvillimit të organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale,

zhvillimin e nismave komunitare si dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e shoqërisë civile.

Takimin e adresoi edhe përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së për Shoqërinë Civile dhe të Drejtat e Njeriut, Z. Stefano Calabretta, i cili nënvizoi ndër të tjera, nevojën për informim dhe ngritjen e kapaciteteve të aktorëve



lokalë për të aplikuar dhe mundësuar thithjen e fondeve dedikuara shoqërisë civile nga Bashkimi Europian.

Ndërkohë Drejtori Ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, z. Sotiraj Hroni, theksoi prioritetin që duhet të marrë ndërmarrja e hapave konkretë nga aktorë të ndryshëm në mbështetje të shoqërisë civile



joqeveritare në zonat urbane, rolin dhe aktivitetin e tyre të dobët në zonat rurale, mungesa e kapaciteteve, fondet e limituara etj.

Me tej ky “Panair Idesh”, u pasua nga prezantimet dhe takimet informuese mes përfaqësuesve të organizatave rurale me donatorët pjesëmarrës dhe përfaqësuesve nga shoqëria civile, me qëllim nxitjen e kontakteve të drejtpërdrejta e partneritetet me aktorë të tjerë institucionalë, të përfshirë në mbështetjen e sektorit civil në vend, si dhe krijimin e mundësive dhe urave të reja të bashkëpunimit në mbështetje të iniciativave të organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.

Në këtë panair më tepër se 100 përfaqësues nga organizatat të ndryshme me fokus në zonat rurale dhe periferike ndanë idetë dhe pikëpamjet e tyre, mbi nisma konkrete të këtyre shoqatave në dobi të përmirësimit të jetës së komuniteteve në rajonet rurale dhe periferike në Shqipëri.



Në brendësi

- Kuqovë: Përfundon Cikli i Aktiviteteve _____ 2
- “IPA” dhe “SENIORA”: Thirrje për Projekt Propozime _____ 2
- Gjirokastrë 2012 Panairi VI Kombëtar i Trashëgimisë dhe Artizanatit _____ 3
- “Gruaja Ndryshe” promovon Vlerat e Trashëgimisë Kulturore _____ 3
- ECSRA: Monitorimi i Nismave _____ 4
- Organizatave Grave në një Rrjet _____ 4

në zonat rurale dhe periferike. Vlerësimi i fundit i situatës së Shoqërisë Civile në Shqipëri, i realizuar nga IDM-ja vetëm pak kohë më parë, nxori në pah problemet më të mprehta të zhvillimit të këtij sektori të rëndësishëm për demokracinë, duke veçuar përqendrimin e madh të organizatave